



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/136

Datë: 14.07.2026

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, dhe në zbatim të nevojave administrative për krijimin e identitetit vizual të institucioneve edukative, Kryetari i Komunës së Junikut, merr këtë:

V E N D I M

- I. AUTORIZOHET Zyrtari i Teknologjisë Informative i Komunës së Junikut, z. Egronit Gaxherri, që në kuadër të detyrave dhe përgjegjësisë së tij zyrtare, të ndërmarrë veprimet teknike për hartimin dhe dizajnimin e tri (3) propozimeve grafike për logon zyrtare të Institucionit Publik Parashkollor “Yjet e Gjeravicës” në Junik.
- II. Zyrtari i autorizuar obligohet që propozimet grafike të përgatitura t’ia dorëzojë Institucionit Publik Parashkollor “Yjet e Gjeravicës” për procedurat e mëtejshme të shqyrtimit dhe miratimit.
- III. Ky autorizim bëhet me qëllim të optimizimit të burimeve brenda administratës komunale dhe efikasitetit në krijimin e identitetit vizual të institucionit parashkollor.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Institucioni Publik Parashkollor “Yjet e Gjeravicës”.
- V. Vendimi hyn në fuqi me rastin e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me këtë vendim njoftohet:

1. Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport;
2. z. Egronit Gaxherri;
3. Arkiva komunale.

Kryetari i Komunës
z. Ruzhdi Shehu